

Përshëndetje të gjithëve,

Jam i nderuar që jam në mesin tuaj sot, dhe ju përgëzoj për bashkëpunimin tuaj që çdoherë e keni me BQK-në.

Një ndër qëllimet strategjike të BQK-së, është nxitja e zhvillimit të shëndoshe të sistemit financiar në Republikën e Kosovës dhe zhvillimi e avancimi i funksionit të edukimit financiar e mbrojtjes së konsumatorit.

Nga viti 2013, BQK themeloi funksionin e Edukimit Financiar dhe përmes aktiviteteve të shumta vazhdon të informojë publikun e gjerë mbi rolin e BQK-së për ekonominë e vendit, zhvillimet në sektorin financiar dhe ekonomik dhe ofrimin e njohurive e informatave edukative financiare. Po të njëjtin vit u anëtarësua në Organizatës Financat Ndërkombëtare për Fëmijë dhe të Rinjë (Child and Youth Finance International) dhe aprovua Strategjinë për Mbrojtje të Konsumatorit dhe Edukim Financiar.

Sistemi financiar është duke evoluar me zgjerimin e gamës së produkteve dhe shërbimeve financiare më komplekse, dhe çështja e edukimit financiar gjithnjë e më shumë ka rol të veçantë në agjendën e rregullatorëve dhe institucioneve financiare. Sektori i shërbimeve financiare ka një peshë të fuqishme në rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, ndërtimin e infrastrukturës vitale dhe zhvillim të qëndrueshëm për Kosovën.

BQK në prill të vitit 2017, ka aprovuar Programin e Edukimit i cili përcakton ndërmarrjen e hapave konkret për avancimin e kësaj fushe. Programi në mënyrë të detajuar përcakton zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve, ngjarjeve dhe materialeve edukative e informuese për publikun.

Gjatë vitit të kaluar ne kemi qenë shumë aktiv në realizimin e shumë aktiviteteve në fushën e edukimit financiar. Po ashtu organizuam dhe mirëpritëm Takimin Rajonal për Edukim Financiar “Takimin e Grupit Punues Rajonal të CYFI për Edukimin Financiar të të Rinjve dhe Përfshirjen Financiare - Evropa Juglindore “ me temën “Trendet dhe zhvillimet në avancimin e edukimit financiar dhe përfshirjen financiare - përvoja nga rajoni” ku Ekspert të Edukimit Financiar nga 10 vende të rajonit dhe më gjerë morën pjesë në këtë takim. Gjithashtu aktivitete të shumta me nxënës të shkollave fillore, të mesme e student u organizuan gjatë tërë vitit.

BQK feston tradicionalisht Javën Ndërkombëtare të Parasë e cila festë shënohet në tërë botën. Këtë vit kjo javë do të shënohet nga 12 deri me 16 mars 2018 dhe motoja është “Çështjet e Parave janë të rëndësishme - Money Matters Matter”. Dita e parë, sot me 12 mars 2018, po shënojmë fillimin e Javës së Parasë së bashku edhe me Shoqatën e Bankave të Kosovës, pastaj gjatë tërë javës do të kemi Ligjërata në Universitete Publike dhe Private. BQK do të lansojë nën faqen (portalin) e edukimit financiar, që përmban informata për të gjitha grupet e interesit si nxënës, fëmijë, të rinjtë, student e konsumator të sektorit financiar.

Po ashtu në kuadër të kësaj javë, BQK shpall një Konkurs për video nga fusha e edukimit financiar, përmes të cilit fton studentët e universiteteve/kolegjeve të nivelit bachelor/master, të marrin pjesë me video edukative të animuara, video klipe, audio klipe, me qëllim të ngritjes së

njohurive, dhe shpërndarjes së informatave nga fusha e edukimit financiar, ekonomisë, kursimet, përdorimi parasë në mënyrën e duhur, funksionet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe tema të ngjashme.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të jetë e përkushtuar që në bashkëpunim me Institucionet tjera relevante të avancojë dhe implementojë Program afatgjatë të edukimit financiar . Përmes avancimit të Edukimit Financiar do të ndikojmë në avancimin e kulturës mbi konceptet themelore financiare për të drejtat e konsumatorëve por edhe përgjegjësitë dhe obligimet e tyre.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj dhe shume suksese në punën tuaj.